**LIGJ**
**Nr.9960, datë 21.7.2008**

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRIVE ZVICERANE ANDRE & CIE, UZIMEX, FLUKA CHEMIE, FICHER CHEMICALS, CIBA-GEIGY (NOVARTIS), FINAGRAIN, TË PËRFAQËSUARA NGA ZOTI EDMOND KËRLIU, PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT TË PRAPAMBETUR, QË DO T'U PAGUHET KËTYRE SHOQËRIVE"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërive zvicerane Andre & Cie, Uzimex, Fluka Chemie, Ficher Chemicals, Ciba-Geigy (Novartis), Finagrain, të përfaqësuara nga zoti Edmond Kërliu, për riskedulimin e borxhit të prapambetur, që do t'u paguhet këtyre shoqërive".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5838, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRIVE ZVICERANE
(Andre&Cie, Uzimex, Fluka, Chemie, Ficher Chemicals, Ciba-Geigy (Novartis, Finagrain)

NË LIDHJE ME RISKEDULIMIN E BORXHIT TË PAPAGUAR
PËR T'IU PAGUAR SHOQËRIVE ZVICERANE

PËRFAQËSUAR NGA Z.EDMOND KERLIU

Marrëveshje e datës ____/____/2008, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu të quajtur "Këshill"), përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar për Negocimin e Borxhit të Jashtëm të Shqipërisë (këtu quhet "GCNEDA") dhe shoqërive zvicerane, të renditura në nenin 1 më poshtë, të përfaqësuara nga z.Edmond Kerliu.

Neni 1

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i borxheve, që rrjedhin nga transaksionet tregtare të përfunduara gjatë viteve 1990-1991, ndërmjet shoqërive zvicerane dhe ish-Ndërmarrjeve Shtetërore të Tregtisë së Jashtme.

Shuma e borxheve është si më poshtë:

| Nr | Emri i shoqërisë | Shuma e borxhit | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Principali | | Interesi & Gjoba |
| | | CHF | USD | USD |
| 1 | Andre & Cie | | 5 014 435,21 | 449 521,87 |
| 2 | Uzimex | 29 300,00 | | |
| 3 | Fluka Chemie | 56 219,00 | | |
| 4 | Ficher Chemicals | 73 328,00 | 102 657,50 | |
| 5 | Ciba –Geigy (Novartis) | 676 312,55 | | |
| 6 | Finagrain | | 328 708,67 | |
| | Totali | 835 159,55 | 5 445 801,38 | 449 521,87 |

Neni 2

Këshilli do të shlyejë borxhin sipas shumës prej CHF 835 159,55 dhe USD 5 895 325,25, në një këst, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 30 qershor 2008.

Neni 3

Këshilli do ta paguajë interesin mbi shumën e borxhit në pajtim me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, me një normë interesi prej 2% në vit për periudhën që fillon në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje deri në datën e shlyerjes.

Neni 4

Në rastin e ndonjë vonese në shlyerjen e pagesës së kërkuar sipas nenit 2, norma e interesit e përcaktuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje do të rritet me një për qind pikë nga data e caktuar e kështit të shlyerjes deri në ditën në të cilën merret pagesa. Kjo rritje nuk zbatohet nëse vonesa në pagesë është më pak se pesëmbëdhjetë ditë.

Neni 5

Pagesa do të kryhet në numrin e llogarisë ....., me....., me.....përkatës.

Neni 6

Kjo Marrëveshje nuk ndryshohet pa pëlqimin me shkrim të të dy Palëve.

Neni 7

Para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, shoqëritë zvicerane duhet të paraqesin aprovimin e tyre për këtë Marrëveshje, me shkrim, nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Tiranë.

Neni 8

Njoftimet që bëhen në pajtim me këtë Marrëveshje, dërgohen në adresat si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Ministria e Financave | Pala zvicerane |
| Departamenti i Përgjithshëm i Thesarit | Edmond Kërliu |
| Bulevardi: Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri | Av.Jomini 8 |
| | CH 1004 Lausanne |
| Tel: ++3554228405 | Tel: + 41 21 641 6734 |
| Fax: ++3554228494 | Fax: +41 21 641 6735 |

Neni 9
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të nevojshme ligjore që kërkohen nga legjislacioni shqiptar dhe mbetet në fuqi derisa Palët të përmbushin detyrimet e tyre të parashikuara prej saj.

Bërë në Tiranë, më ……2008, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.